

VENDIM
Nr. 793, datë 11.12.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1148, DATË 25.11.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'RRUGA HYRËSE FIER'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1148, datë 25.11.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) tabelave bashkëlidhur vendimit i shtohet edhe tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

b) në pikën 3, për pasuritë e llojit tokë "trual", sipërfaqja 1 139.4 (një mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë katër) m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 13 672 800 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh, ndryshon dhe bëhet 1 158.8 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë pikë tetë) m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 13 914 485 (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

c) pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 372 500 (treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen, përkatësisht:

- 322 500 (treqind e njëzet e dy mijë e pesëqind) lekë nga Autoriteti Rrugor Shqiptar;

- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.";

ç) pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

"5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 13 914 485 (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga:

- llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë, shuma 9 488 400 (nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë;

- buxheti i vitit 2015, zëri "Detyrime të prapambetura", shuma 4 184 400 (katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë;

- buxheti i vitit 2019, zëri "Shpronësime", miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor "Transporti rrugor", shuma 241 685 (dyqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, si dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIN RRUGOR
“RRUGA HYRËSE FIER” (Shtesa)**

Pronaret				Të dhënat (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË												Vlera totale (lekë)	Adresa	Shënime	
Nr .	Emri	Atësi a	Mbiemri i	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë “arë”			Shpronësim tokë “truall”		Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Ndërtesë banimi (shtëpi)			Ndërtesë jobanimi					Vl. kult. bujq. dru-frut. (lekë)
								Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)			Vlera (lekë)	Sip.ndërt. konf. ZVRPP (m²)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas zvrpp (l/m²)	Vlera (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP- ja (m²)				
1	Kozma	Naun	Kulari	8532	3/446	Truall	440.3				9.7	12458								120,842.60	Sheq i madh, rr. “Teodor Muzaka” , banesa nr. 93, përballë DPQRR-së	Konf. nga ZVRPP-ja	
2	Kristaq	Naun	Kulari	8532	3/449	Truall	440.3				9.7	12458								120,842.60	Sheq i madh, rr. “Teodor Muzaka” , banesa nr. 93, përballë DPQRR-së	Konf. nga ZVRPP-ja	
	SHUMA										19.4									241685.2			